



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 82 dt.28.06.1995

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.28.06.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike mbështetur në V.K.M. Nr.163, dt.03.04.1993.

VENDOSI

1. Të miratojë kalimin në fond banese të dy ish magazinave të shkatërruara të cilat i kanë adaptuar me shpenzimet e tyre 8 familje ish të përndjekur politik të ardhur nga kampi i Lushnjes, të cilat ndodhen në qytetin e Nxënësve, (përballë magazinës ekzistuese, të arsim kulturës).
2. Ngarkohet Seksioni i Strehimit të pajisi me autorizim të 8 familjet e propozuara nga Komiteti ish të përndjekurve politik, sipas dispozitave ligjore në fuqi personat e mëposhtëm :
Ramiz Mena, Mitat Mena, Ahmet Kola, Nezir Kola, Skënder Meta, Shefki Cami, Napolon Cami, Subi Cami.
3. Të miratojë kalimin në fond banese për sistemimin provizorisht të rasteve emergjente që ka Bashkia të ambientit që mbetet i lirë duke zbritur sipërfaqen 120m² e cila me vendim të A.K.P. Tiranës është

privatizuar në emër të Z.Ali Nelku nga e gjithë sipërfaqja e objektit që ka patur N.K.Banesa Nr.3 për sektorin Nr.3 që ndodhet në Rr.”4 Dëshmorët”. Kjo sipërfaqe e mbetur për fond banese është 94m² i jepet Hane Shtyllës e të tjerë.

4. Të kalojë në fond banese ambjenti ish zyrë fronti e lagjes Nr.47 i cili ndodhet në Rr.”Bardhyl” pallati.II për sistemimin e qytetarit Agim Hamdi Topi i cili rezulton i pastrehë, njëkohësisht dhe si trashigimtar ligjor i ish pronarit të truallit që është njohur pronësia me të drejtën e parablerjes së këtij objekti.
5. Ngarkohet Seksioni i Strehimit të pajisi me autorizim qytetarin Agim Hamdi Topi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA